



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1409 Prot.

Tiranë, më 11 / 11 2019

VENDIM Nr. 240, datë 08.11.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 13, datë 08.11.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Ndërtimi i HEC GASTRA" Bashkia Elbasan*-subjekti "AB 01 ENERGJI" sh.p.k., realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Znj. Lida Miraj,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të *projektit "Ndërtimi i HEC GASTRA" Bashkia Elbasan*-subjekti "AB 01 ENERGJI" sh.p.k., realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Znj. Lida Miraj.
2. Subjekti "AB 01 ENERGJI" sh.p.k, duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "*Ndërtimi i HEC GASTRA" Bashkia Elbasan*, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrisë Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO